

VENDIM
Nr. 66, datë 14.2.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 65, DATË 8.2.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I AKSEVE
RRUGORE ‘UNAZA LINDORE, LOTI II’ DHE PROBLEMATIKAT E RRUGËVE
DYTËSORE TË OBJEKTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 65, datë 8.2.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 3, vlera “... 51 783 837.3 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë tre) lekë ...” zëvendësohet me “... 52 861 542.3 (pesëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy mijë pikë tre) lekë ...”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 52 861 542.3 (pesëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy mijë pikë tre) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) vlera prej 51 783 837.3 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë tre) lekësh, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar;

b) vlera prej 1 077 705 (një milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesë) lekësh, nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

c) në pikën 10, pas emërimit “Agjencia Shtetërore e Kadastrës ...” shtohet “... Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1...”.

ç) tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

4. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA SHITESË E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË
SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTT “RIKUALIFIKIMI I
AKSEVE RRUGORE ‘UNAZA LINDORE, LOTI II’ DHE PROBLEMATIKAT E RRUGËVE DYTËSORE
TË OBJEKTIT”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (sipas kartelës së pasurisë)				TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM									Konfirmimet	SHËNIME	Adresa	
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"		Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Objekt social-ekonomik					VLERA TOTALE (lekë)
								Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Sip. e ndërtesës			Vlera e preventivit					
11	Besnik	Haxhi	Balla	1604	45/13	truall	500				107	5140	549980			549980	Konfirmuar nga ASHK-ja	Shënim. Seksioni. E "Godinë banimi 2kat + 1 kat nën tokë +109.5m² kati përdhe =108.1m² sip verande=30.1 sip kat i parë 108.1m² sip verande 36.5 sip papafingo=80.5m² sip.verande=19.5m² sip.katit përdhe objekti ndihomës=35.3m²". Objekti i banimit sipas dokumentacionit të lëshuar nga ASHK-ja nuk preket nga shpronësimi.	Tiranë, Shkozë	
12	Nazif	Tahir	Hate	3976	236/193	truall	20				6	479	2874	15.2	432973.98	435848	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë	
	Tahir	Nazif	Hate																	
13	Artur	Novruz	Hysenaj	3976	234/24	truall	450				59	479	28261			28261	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë	
	Ajet	Novruz	Hysenaj																	
14	Halim	Tahir	Hate	3976	236/13	arë	600	25	448	11200						11200	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë	
15	Besnik	Haxhi	Balla	1604	45/11	arë	930	117	448	52416						52416	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Surrel	
Vlera totale																	1077705			